29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFECTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet eaktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-6830-5-2-1/C820

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 13 muaj . Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjër në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditë kalendarike nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit .
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite pas nënshkrimit të kontratës .
	17.2	Përfundimi i të gjitha punëve do të jetë për 30 ditë, brenda 12 muajve, sipas urdhërësës së menaxherit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë . Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 37 muaj nga përfundimi i punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Projekti kryesor i rrugës "Dërgut Vokshi", Gjakovë

Paramasa dhe Parallogaria

Rruga

AKSI 1: L=0+339.95 km, B=5.00 m dhe B=4.50 m, br=2x(0.20-1.00) m

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasla	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
Punët Përgaditore					
1	Punët përgaditore për fillimin e punimeve, mobilizimi i makineris dhe vendosja e shenjave të nevojshme për sigurinë dhe parajmerim të vendpunishës.	komplet	1.00	4,362.65	4,362.65 €
2	Pastrimi i terronit, kontrollimi i instalimeve nantokësore dhe largimi të gjitha pengesave të ndryshme në trasenë e rrugës. Materialet e larguara transportohen në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km. Për fillimin të punimeve, investitori duhet të sigurojë të dhënat e instalimeve. Në rast të dëmtimit të instalimeve ekzistuese, duhet të rregullojë vetë punëkryesit.	m'	339.95	6.00	2,039.70 €
3	Shenjëzimi i trasenë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet	m'	339.95	5.00	1,699.75 €
5	Demolimi i kubëzave të betonit apo gurit që gjenden në trotualet e rrugës së projektuar. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km	m ²	252.50	5.00	1,262.50 €
6	Demolimi i sipërfaqeve nga betoni që gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km	m ²	301.29	6.00	1,807.74 €
7	Demolimi i kubëzave të granitit me trashësi t=10 cm dhe transporti në lokacionin e caktuar nga investitori max 5km. Materiali i demouar do të shfrytëzohet nga investitori për një projekt tjetër	m ²	1,605.70	5.00	8,028.50 €
8	Demolimi i rigollës së bashku me beton. Transporti në deponinë e caktuar bëhet nga investitori. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori max 15 km.	m'	339.95	7.00	2,379.65 €
9	Demolimi i gurëve skajorë 16/24 cm së bashku me beton. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	679.90	5.00	3,399.50 €
10	Demolimi i gurëve skajorë 10/24 cm së bashku me beton. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	100.00	5.00	500.00 €
11	Demolimi dhe ngritja e puselave ekzistuese drejtkëndëshe dhe tjera të elektrikes të cilat kanë nevojë të përshiten me niveleten e re, duke përshfshirë rregullimin e konusit dhe zëvendësimin e kapakëve të dëmtuar me peshë deri në 42 t. Rregullimi i kokës së puselave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori max 15 km.	copë	2.00	850.00	1,700.00 €
12	Demolimi i puselave ekzistuese të ujësjetillës, kanalizimit fokal apo atmosferik të cilat gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	copë	18.00	150.00	2,400.00 €
13	Demolimi i puselave ekzistuese të ujësjetillës të cilat gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	copë	2.00	50.00	100.00 €
14	Demolimi i gypave ekzistues të kanalizimit atmosferik. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	363.65	4.00	1,454.60 €
15	Demolimi i gypave ekzistues të kanalizimit fokal. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	365.96	4.00	1,463.84 €
16	Demolimi dhe ngritja e puselave ekzistuese drejtkëndëshe dhe tjera të PTK të cilat kanë nevojë të përshiten me niveleten e re, duke përshfshirë rregullimin e konusit dhe zëvendësimin e kapakëve të dëmtuar me peshë deri në 42 t. Rregullimi i kokës së puselave duhet të punohet me beton të armuar. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori max 15 km.	copë	1.00	300.00	300.00 €
17	Demolimi i ujëmbledhësve me të gjitha elementet e tyre përcjellëse siç janë grilla, pusela nga betoni, pllaka e poshtme dhe gypat shkarkues, që gjenden në trasenë e rrugës së projektuar. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori max 15 km.	copë	25.00	20.00	500.00 €
18	Dislokimi i shtyllave ekzistuese të betonit me lartësi H=9m këndore tip 40*, me bazament të betonit duke përshfshirë gërmimin për bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokësimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazës, vendosja e konzolës (për rjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nase ekzistues) si dhe demontimi dhe montimi i seriherm i kabllove ekzistuese ajrore dhe nantokësore eventuale dhe materialit tjetër i nevojshëm komplet me atësa për një shtyllë të dislokuar.	copë	4.00	280.00	1,120.00 €
19	Dislokimi i shtyllave ekzistuese të drurit si dhe vendosja e shtyllave të reja të betonit me lartësi H=9m këndore tip 40*, me bazament të betonit duke përshfshirë gërmimin për bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokësimit Fe/Zn 25x4mm(3.5mm), reren e imet, montimin e unazës, vendosja e konzolës (për rjet ajror 0.4kV), trupave ndriçues (nase ekzistues) si dhe demontimi dhe montimi i seriherm i kabllove ekzistuese ajrore dhe nantokësore eventuale dhe materialit tjetër i nevojshëm komplet me atësa për një shtyllë të dislokuar.	copë	6.00	200.00	1,200.00 €
20	Demolimi dhe rivendosja e rrethjes (rrethojë, tel me gjemba)	m'	25.00	10.00	250.00 €
21	Demolimi i mureve nga materialet e ndryshme si gurët, betoni apo blloqet, me lartësi mesatare (1.5-2.5) m. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m'	50.00	50.00	2,500.00 €
22	Gërryerja e asfaltit dhe deponimi në vendin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km. Rruga ka dy shtresa asfalti dhe atë me trashësi 6+4 cm. Materiali i demouar transportohet në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m ²	359.42	2.00	718.84 €
23	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (në rast të ndryshimit nga gjendja e projektuar).	m'	339.95	2.00	679.90 €
Gjithsej totali me TVSH					39,865.17 €
Punët e Dheut					
1	Gërmimi i dheut të kategorisë III-IV në trupin e rrugës dhe pjesët ku do të bëhet sanimi i trupit rrugor në pjesët ku është e nevojshme, bartja e tij në deponi të përshfshirë në largësi deri në 15 km e caktuar nga investitori. Pjesa e materialit të gërmuar e cila është me përmbajtje gurorë mund të përdoret për mbushje në profilin ku mbushja është me e madhe se t=1.0 m. Në këtë pozicion është illogaritur edhe rregullimi i kyqeve.	m ³	2,122.19	6.00	12,733.14 €
2	Nivellizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shfritës duhet të jetë Mv >35 MPa.	m ²	2,040.37	2.00	4,080.74 €
Gjithsej totali me TVSH					16,813.88 €
Punët e Zhavorit					
1	Furnizimi, shfritja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethor mbushës. Moduli i shfritës duhet të jetë Mv >40 MPa. Në këtë pozicion është illogaritur edhe sasja e materialit mbushës për sanimet në trupin e rrugës nëse ka nevojë.	m ³	200.00	4.00	800.00 €
2	Furnizimi, shfritja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushës 0-150mm (t=40 cm). Moduli i shfritës duhet të jetë Mv >50 MPa. Në këtë pozicion është illogaritur edhe sasja e materialit mbushës për kryqëzimin të sfelionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyqeve anësore.	m ³	650.70	14.00	13,310.92 €

3	Furnizimi, shërbija dhe ngjeshja e zhavorit 0-83mm, l=20 cm. Moduli i shatërsjes duhet të jetë $M_v > 70$ Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyojeve anësore.	m ³	519.25	14.00	7,269.50 €
4	Furnizimi, shërbija dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm l=10cm. Moduli i shatërsjes duhet të jetë $M_v > 90$ Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyojeve anësore.	m ³	237.26	14.00	3,321.64 €
5	Furnizimi, shërbija e gjeotekstilit 400 gr/m2 Naue ose të ngjashme (me norma evropiane CE, ETA, EPD, EN ISO 9864, 9863-1, 10319, 12236, 12958, 11053) në nëntazën e rrugës. Pallimi i gjeotekstilit duhet të jetë i rregullt 30 cm njëri mbi tjetrin. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e gjeotekstilit për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyojeve anësore.	m ²	1,680.80	0.50	845.40
6	Furnizimi dhe shërbija e rërës për mbrojtje të gjeotekstilit nga dëmtimet e mundshme 1-5.0 cm. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e rërës për kryqëzimin te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyojeve anësore.	m ³	84.54	6.00	507.24 €
7	Furnizimi, shërbija dhe kompaktimi i zhavorit (material shërb nga gurthuesit) për punimin e benkinave	m ³	30.00	6.00	180.00 €
Gjithsej totali me TVSH					26,234.70 €
IV	Punët e Betonit				
1	Gurët skajorë dhe kubëzat				
1	Furnizimi, shërbija dhe ngjeshja e rërës 10-20mm, d=5cm (në gjendje të ngjeshur)	m ³	29.60	12.00	355.20 €
2	Furnizimi dhe montimi i Gurëve skajorë nga betoni 18/24 cm, të klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llag qimentoje si dhe përpunimin e tyre. Gjerësia e fugave të jetë 12mm (±2mm))	m ³	690.55	14.00	9,667.70 €
3	Furnizimi dhe montimi i Gurëve Skajor nga betoni 10/20 cm, të klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llag qimentoje si dhe përpunimin e tyre. Gjerësia e fugave të jetë 12mm (±2mm))	m ³	100.00	10.00	1,000.00 €
4	Furnizimi dhe montimi i kubëzave nga betoni me trashësi l=8cm për trotuare. Kubëzat duhet të jenë të klasës C-30/37. Ngjyra dhe modeli të zgjedhen nga investitori.	m ³	598.00	15.00	8,970.00 €
Gjithsej totali me TVSH					19,992.90 €
V	Punët e Asfaltit				
1	Furnizimi, shërbija dhe ngjeshja e asfaltit AB 15 mm duke përfshirë edhe sasinë për kyçet e rrugëve ekzistuese, l=8cm	m ²	1,705.13	9.00	15,346.17
2	Furnizimi, shërbija dhe ngjeshja e asfaltit BA 0/22 mm në rrugë, l=8cm. Në këtë pozicion është llogaritur sasia e asfaltit për realizimin e kyojeve.	m ²	358.42	10.00	3,584.20
3	Spërkalla (yryja) e shtresës së parë të asfaltit me emulsion 0.5 lit/m ² . Në këtë pozicion është llogaritur sasia e asfaltit për realizimin e kyojeve.	m ²	358.42	1.00	358.42
4	Furnizimi, shërbija dhe ngjeshja e asfaltit AB11-a mm (zhavori është nga guri eruptiv) l=4cm. Në këtë pozicion është llogaritur sasia e asfaltit për realizimin e kyojeve.	m ²	358.42	5.00	1,792.10
Gjithsej totali me TVSH					21,080.89 €
VI	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit				
1	Testimet e Ngjeshmërisë	komplet	1.00	100.00	100.00 €
2	Testimet e Asfaltit	komplet	1.00	200.00	200.00 €
3	Testimet e gurëve skajorë	komplet	1.00	100.00	100.00 €
4	Testimet e kubëzave të betonit	komplet	1.00	100.00	100.00 €
Gjithsej totali me TVSH					500.00 €

Rekapitulimi		
I	Punët Pregaditore	39,865.17 €
II	Punët e Dheut	16,813.88 €
III	Punët e Zhavorit	26,234.70 €
IV	Punët e Betonit	19,992.90 €
V	Punët e Asfaltit	21,080.89 €
VI	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	500.00 €
Gjithsej totali me TVSH		124,487.54 €

Projekti kryesor i rrugës "Dërgut Vokshi", Gjakovë					
Kanalizimi atmosferik					
Paramasa dhe Parallogaria					
Kolektori I: L1=0+333.65 km					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I	Punët pregaditore				
1	Shanlezimi i lirasës dhe përcjellja e punimeve me gjeodet. Në teren duhet të bëhet pikërimi i të gjitha pushtave sipas projektit dhe përcjellja e punimeve gjatë ekzekutimit. Në llogarë është marrë gjatësia e trasës nëpër të cilën kalojnë gypat.	m ¹	333.65	1.00	333.65 €
2	Demolimi i gurëve me llag bashkë me shiresat poshtë saj për rastin e shkrëkimit të gypit të kanalizimit atmosferik deri te pushta e lumit Krena. Materiali i demouar mund të përdoret përsëri nëse nuk dëmtohet. Materiali i demouar largohet deri në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	m ²	6.00	20.00	120.00 €
3	Demolimi i kyojeve ekzistuese dhe largimi i materialit të demouar në deponinë e caktuar nga investitori në largësi max 15 km.	copë	30.00	10.00	300.00 €
4	Inçizimi dhe punimi i projektit të gjendjes së ekzekutuar (në rast se projekti përshkon gjatë realizimit).	m ¹	333.65	2.00	667.30 €
Gjithsej totali me TVSH					1,420.95 €
II	Punët tokësore				



1	Gërmimi i kanalit për kolektorit kryesor, kat. III-IV me gjërësi sipas profileve të projektit, dhe transporti i dhout të gërmuar në vendin ku e caktan investitori, në largësi deri në 5 km. Te largimi i dhout te gërmuar behet vetëm pjesa e mbetur që nuk kthehet në kanal. Po ashtu në këtë pozicion është parapara edhe gërmimi i materialit për zgjerime tek puseta. Llogaritja është bërë për nivelin prej fundit të kanalit deri te shtrasa e zhavorrit 0-150 mm.				
1.1	Gërmimi me makinë 90%	m³	976.03	5.00	4,880.15 €
1.2	Gërmimi me dorë 10 %	m³	97.60	5.00	488.00 €
2	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktezi ±1cm.	m³	424.74	1.00	424.74 €
3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rorës 0-16 mm në fundin e kanalit anash dhe mbi tub dhe ngjeshja (10 cm rorë vendosën nën gyp dhe 15 cm mbi gyp dhe pjesa tjetër anash gypit). Në llogaritje është përfshirë edhe sasia e rorës rreth gypave të ujëmbledhësve.	m³	264.27	10.00	2,642.70 €
4	Furnizimi, shfritja dhe ngjeshja e materialit gurorë rrethor mbushës për mbulimin e gypave dhe rreth pusetave. Modulli i shafitjes duhet të jetë Mv >50 MPa. Llogaritja është bërë prej shtrësasë së rorës deri te niveli i zhavorrit 0-150 mm.	m³	832.60	10.00	8,326.00 €
5	Furnizimi me material dhe sigurimi i kanalit ndaj shembjes së dhout	m³	2,476.46	0.50	1,238.23 €
6	Furnizimi dhe vendosja e shiritit paralajmëruar për kanalizim, që vendosët 40 cm mbi gyp	m³	333.65	0.50	166.83 €
7	Furnizimi, transporti, shfritja, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorrit 0-63 mm nën pllakën e poshtme të pusetave, me trashësi t=20 cm. Modulli i ngjeshjes duhet të jetë Mv >50 MPa	m³	8.19	10.00	81.90 €
Gjithsej totali me TVSH					18,248.55 €

III	Punët montuese				
1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8				
1.2	SN8 Ø 630 mm	m'	333.65	40.00	13,346.00 €
2	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8 Ø 160 mm për ujëmbledhës të kanalizimit atmosferik	m'	42.00	5.00	210.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN8 Ø 250 mm për kyqe nga rrugët sekondare	m'	45.00	7.00	315.00 €
4	Sigurimi dhe montimi i shkatërrimeve prej shufrave të çelikut Ø 25 mm çdo 30 cm sipas detajit në projekt.	copë	192.00	5.00	960.00 €
Gjithsej totali me TVSH					14,831.00 €

IV	Punët e betonit dhe armaturës				
